FEDERATA E SHENJËTARISË SPORTIVE E KOSOVËS
SPORTSKA STRELJAČKA FEDERACIJA KOSOVA
KOSOVO SHOOTING SPORT FEDERATION
Adresa: Rr. Agim Ramadani Nr. 43 Shtëpia e Sporteve Prishtinë, Kosovë.
Tel.Fax: ++381 (0) 38 244 473, mobil:
e-mail: info@fshsk.org, gezim.hazrolli@fshsk.org

Nr. Prot/ 004/2026 **Prishtinë: 23.01.2026**

Lënda: Thirrje për propozimin e kandidatëve për Komisionet e FSHSK-së
(bazuar në nenet 14, 15 dhe 28 të Statutit të FSHSK-së)

Të nderuar përfaqësues të klubeve anëtare,

Në bazë të **nenit 14**, **nenit 15** dhe **nenit 28** të Statutit të Federatës së Shenjëtarisë Sportive të Kosovës (FSHSK), si dhe në përputhje me vendimet e Këshillit Drejtues, FSHSK shpall **thirrje për propozimin e kandidatëve** për përbërjen e komisioneve të Federatës.

I. Komisionet për të cilat kërkohen propozime

1. Komisioni i Sportistëve (Garuesve)
2. Komisioni për Financa dhe Auditim
3. Komisioni Ligjor
4. Komisioni Statutar
5. Komisioni Mjekësor
6. Komisioni "Femra dhe Sporti"
7. Komisioni për Marrëdhënie Ndërkombëtare
8. Komisioni i Referëve
9. Komisioni i Trajnerëve
10. Komisioni i Garave

Komisioni Disiplinor dhe Komisioni i Ankesave nuk janë pjesë e kësaj thirrjeje, pasi që janë tashmë të zgjedhur në përputhje me Statutin e FSHSK-së në Kuvendin e kaluar të FSHSK-së.

II. Kushtet për nominim dhe përzgjedhje

(Nenet 14 dhe 15 të Statutit të FSHSK-së)

1. Kandidati duhet të propozohet nga një klub anëtar i FSHSK-së dhe të ketë **pëlqim me shkrim të klubit** (bazë deleguese).
2. Një person mund të propozohet **vetëm për një (1) komision**.
3. Kandidati duhet të ushtrojë detyrën në mënyrë **të pavarur dhe të paanshme**, duke pasur parasysh interesin e FSHSK-së si tërësi.

4. Kandidati nuk duhet të jetë në konflikt interesi dhe nuk mund të jetë person në marrëdhënie pune me FSHSK-në.
5. Në përbërjen e komisioneve do të synohet përfaqësimi i të dy gjinive, për aq sa është e mundur.
6. Secili klub anëtar i FSHSK-së ka të drejtë të bëjë dy (2) nominime për dy (2) komisione të ndryshme.

III. Dokumentacioni i nevojshëm për propozim

1. Propozimi zyrtar i klubit (i nënshkruar dhe i vulosur)
2. Të dhënat personale të kandidatit (emër, mbiemër, datëlindje)
3. Biografi e shkurtër (CV)
4. Kopje e licencës përkatëse (nëse aplikohet)

IV. Afati dhe mënyra e dorëzimit

Propozimet duhet të dorëzohen **jo më vonë se 26 / 01/ 2026**,
në formë elektronike në emailin zyrtar të FSHSK-së **info@fshsk.org**

Propozimet e dorëzuara pas këtij afati **nuk do të shqyrtohen**.

V. Dispozitë përfundimtare

Propozimet e pranuara do të shqyrtohen dhe miratohen nga **Këshilli Drejtues i FSHSK-së**, në përputhje me kompetencat e tij statutore.

Me respekt,
FEDERATA E SHENJËTARISË SPORTIVE TË KOSOVËS
Këshilli Drejtues

Kryetari i FSHSK-së
Gëzim Hazrolli